

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L.
Dege e shoqërisë së huaj

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
1 Informacion i Përgjithshëm	7
2 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare.....	7
3 Përmbledhje e politikave kontabël.....	7
4 Mjetet monetare.....	12
5 Llogari të arketueshme	12
6 Llogari të tjera të arketueshme	12
7 Shpenzime të periudhave të ardhshme.....	12
8 Inventare.....	13
9 Aktivët afatgjatë materiale	13
10 Llogari të pagueshme	13
11 Detyrime tatimore	14
12 Detyrime të tjera afatshkurtra	14
13 Shitjet neto.....	14
14 Punime nga nenkontraktore.....	14
15 Kosto e punës.....	15
16 Shpenzime të tjera.....	15
17 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15
18 Angazhime dhe ngjarje të kushtëzuara	16
19 Ngjarje pas datës së bilancit.....	16

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
 PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 më 31 Dhjetor 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Shënime</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe te tjera ekuivalente	4	110,344,179	124,956,698
Llogari te arketueshme	5	53,599,749	-
Llogari te tjera te arketueshme	6	37,965,534	7,814,109
Shpenzime te periudhave te ardhshme	7	3,867,263	59,919,363
Inventare	8	-	1,234,075
Total iaktiveve afatshkurtra		205,776,725	193,924,245
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata material	9	1,577,865	-
Totali i aktiveve afatgjata		1,577,865	-
Totali i aktiveve		207,354,591	193,924,245
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet afatshkurtra			
Te pagueshme tregtare	10	79,584,712	32,398,865
Detyrime te tjera afatshkurtra	12	117,359,508	158,473,374
Totali i detyrimeve afatshkurtra		196,944,220	190,872,238
Totali i detyrimeve		196,944,220	190,872,238
Kapitali			
Kapitali aksioner		-	-
Fitimet (humbjet) e akumuluar		3,052,007	-
Fitimi (humbja) e vitit		7,358,364	3,052,007
Totali i kapitalit		10,410,371	3,052,007
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		207,354,591	193,924,245


Bilanci Kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi në datën 24.03.2020 dhe janë nënshkruar nga:

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E
 CASTELLI S.R.L.
 Administratori

CASTELLI ALBINO

MB CONSULTING SHPK
 Pergatiti



Impresa di Costruzioni
 Albini e Castelli S.r.l.
 Dege e shoqërisë së huaj
 NUIS : L 81516017 S, Tirane



IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
PASQYRA E PERFORMANCËS
 për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Shënime</u>	<u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019</u>	<u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018</u>
Shitjet neto	13	<u>279,107,021</u>	<u>49,899,592</u>
Te ardhurat totale		279,107,021	49,899,592
Punime nga nenkontraktore	14	(225,781,525)	(37,610,094)
Kosto e punës	15	(174,096)	(66,482)
Amortizimet	9	(210,156)	-
Shpenzime të tjera	16	<u>(44,483,483)</u>	<u>(7,920,436)</u>
Totali i shpenzimeve		<u>(270,649,260)</u>	<u>(45,597,012)</u>
Fitimi (Humbja) nga veprimtaria kryesore		<u>8,457,761</u>	<u>4,302,580</u>
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit		373,236	(516,274)
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi		-	-
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		<u>373,236</u>	<u>(516,274)</u>
Fitimi (Humbja) para tatimit		<u>8,830,997</u>	<u>3,786,307</u>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	<u>(1,472,633)</u>	<u>(734,300)</u>
Fitimi (Humbja) e vitit		<u>7,358,364</u>	<u>3,052,007</u>
Te ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		<u>7,358,364</u>	<u>3,052,007</u>

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO
 për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

	<u>Kapitali aksionar</u>	<u>Fitimet e pashpërndara</u>	<u>Totali</u>
Gjendja më 1 janar 2018	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
Emetimi i kapitalit aksioner	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	3,052,007	3,052,007
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	<u>-</u>	<u>3,052,007</u>	<u>3,052,007</u>
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	7,358,364	7,358,364
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	<u>-</u>	<u>10,410,371</u>	<u>10,410,371</u>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
 për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë)

<u>Shënime</u>	<u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019</u>	<u>Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018</u>
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi (humbja) pas tatimit	7,358,364	3,052,007
Rregullime për:		
Amortizim dhe zhvleresim	210,156	
Shpenzimet e tatim fitimit	1,472,633	734,300
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	9,041,153	3,786,307
Rritje (rënie) në llogaritë e arkëtueshme e të tjera	(27,699,074)	(67,733,472)
Rritje (rënie) në inventaret	1,234,075	(1,234,075)
Rritje (rënie) në llogaritë e pagueshme e të tjera	1,318,484	190,092,939
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(16,105,362)	124,911,698
Tatim fitimi i paguar	3,280,865	45,000
Interesa të arkëtuara	-	-
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(12,824,497)	124,956,698
Fluksi monetary nga veprimtaritë e investimit		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale edhe jomateriale	(1,788,022)	-
Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e investimit	(1,788,022)	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i mjeteve monetare	(14,612,519)	124,956,698
Mjetet monetare në fillim të periudhës	124,956,698	-
Mjetet monetare në fund të periudhës	110,344,179	124,956,698

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7-16, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019**
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

1 INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. Dege e shoqërisë së huaj ("Shoqëria") është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 16/03/2018 me numër identifikimi NUIS L81516017S.

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Abdyl Frasherit, Nderresa 8, Hyrja 7, Ap.25, 1019, Tirane.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është Punime ndertimi te çdo lloji e natyre.

2 BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur ne përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK).

Bazuar ne SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar ne koston historike, përveç rasteve nëse specifikohet ndryshe.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë pasqyruar në Lekë e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Shifrat janë të rumbullakosura në Lekë.

2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare në përputhje me SKK, kërkon qe menaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, te ardhurave e shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm në varësi të rrethanave. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi si dhe ne çdo periudhe te ardhme që preket.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

2.5 Periudhat krahasuese

Të dhënat e periudhave të mëparshme mund të ri klasifikohen për t'i bërë ato të krahasueshme me paraqitjen e të dhënave të periudhës ushtrimore.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël ne vijim janë aplikuar ne mënyre te qëndrueshme ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare, me përjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe nëse ka te tilla.

3.1 Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Mjetet monetare ne monedhe te huaj rivlerësohen ne fund te çdo periudhe raportuese me kursin zyrtar te këmbimit ne datën e raportimit.

**IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)**

Mjetet jo-monetare në monedhe të huaj regjistrohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa mjetet jo-monetare që maten me vlerë të drejte rivilerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejte.

Fitimi ose humbja që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertim në 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019 LEK	31 Dhjetor 2018 LEK
EURO	121.77	123.42

3.2 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejte plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria behet pale në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një pale e treta pa mbajtur kontrollin ose gjithërrëzimet dhe përfitimet helbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet deri në tre muaj.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejte dhe me pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jete në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejte dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektive.

Huamarrjet dhe parapaqimet

Huat e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejte, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektive, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektive.

Metoda e normës efektive të interesit është një metode për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e

**IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)**

interesit është norma e cila skanton saktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuarapërgjatëjetës se pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, përnjë periudhe me të shkurtër.

Te tjera

Instrumente të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueseje, duke përdorurmetodën e normës se interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

3.3 Aktivët afatgjatë materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto, duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëriapërfshin koston e materialeve dhe punësdireket dhe çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune përqëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinëpërkatesë të aktivit kur përfundonndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatesë sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato regjistrohen si zëra të ndryshëm të ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtëpërdorimit të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurën nga shitja me vlerënkontabël neto të aktivit afatgjatë material mbetur dhe njihen në të ardhura ose humbje të tjera.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjatë materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira financiare amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivët në proces nuk amortizohen. Metodatat dhe normat e amortizimit përperiudhën aktuale dhe të mëparshmejanë si më poshtë:

Ndërtesa	5%	(mbi vlerën e mbetur)
Makineri dhe pajisje	20%	(mbi vlerën e mbetur)
Mjete transporti	20%	(mbi vlerën e mbetur)
Pajisje kompjuterike	25%	(mbi vlerën e mbetur)
Pajisje zyre dhe të tjera	20%	(mbi vlerën e mbetur)

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha koston e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

**IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019**
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

Pas njohjes fillestare inventarëtvlerësohen me vlerën më të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit përcaktohet sipas metodës së mesatares së ponderuar. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuar të nevojshme për të kryer shitjen, sipas metodës së kostos mesatare të ponderuar.

3.5 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti dhe të cilat mund të maten me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të aktualizuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale, ndërsa aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë që ka pësuar rënie në vlerë. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Gjatë ecurisë normale të aktivitetit të saj, shoqëria paguan kontributet shoqërore dhe shëndetësore në emër të vet dhe të punonjësve të saj, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislationit Shqiptar në fuqi. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

3.7 Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer këto detyrime. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që shoqëria do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, për shlyerje të menjëhershme etj.

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përketin. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat njihen kur ndryshimi i pronësisë së bashku me rrezikun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi. Te ardhurat nga shërbimet njihen kur shërbimi është kryer, në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

**IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3.9 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesat për llogarite bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga luhatjet e kurseve të këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejte të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet pasqyrës së te ardhurave dhe shpenzimeve, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare.

Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e teardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

3.11 Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

4 MJETET MONETARE

Gjendja e mjeteve monetare në arke dhe bankë në fund të vitit ushtrimor paraqitet si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë	110,341,140	124,955,578
- në Lekë	110,341,140	476,077
- në monedhë të huaj	-	124,479,501
Mjete monetare në arkë	3,039	1,120
- në Lekë	3,039	1,120
- në monedhë të huaj	-	-
Totali	<u>110,344,179</u>	<u>124,956,698</u>

5 LLOGARI TE ARKETUESHME

Llogarite e arketueshme me 31.12.2019 dhe 31.12.2018 perbehen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kliente	53,599,749	-
Totali	<u>53,599,749</u>	<u>-</u>

6 LLOGARI TE TJERA TE ARKETUESHME TATIMORE

Llogarite e tjera te arketueshme tatimore perbehen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6,881,453	7,814,109
Garanci dhënë të tretëve	1,808,232	-
Te tjera tatime	16,275	-
Parapagime të dhëna ne Euro	29,259,574	-
Totali	<u>37,965,534</u>	<u>7,814,109</u>

7 SHPENZIME TE PERIUDHAVE TE ARDHSHME

Shpenzimet e periudhave te ardhshme perbehen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Shpenzime te periudhave te ardhshme per sigurime	3,867,263	10,226,948
Shpenzime te periudhave te ardhshme	-	281,250
Te ardhura te llogaritura	-	49,411,165
Totali	<u>3,867,263</u>	<u>59,919,363</u>

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

8 INVENTARE

Inventaret perbehen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	-	1,234,075
Totali	-	1,234,075

9 AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	<u>Makineri dhe pajisje</u>	<u>Mobilje dhe pajisje zyre</u>	<u>Pajisje informatike</u>	<u>Totali</u>
Kosto				
Gjendje me 01.01.2018	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2018	-	-	-	-
Shtesa	1,754,520	27,677	5,825	1,788,022
Pakësime	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2019	1,754,520	27,677	5,825	1,788,022
Amortizimi				
Gjendje me 01.01.2018	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2018	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	204,694	4,613	849	210,156
Pakësime	-	-	-	-
Gjendje me 31.12.2019	204,694	4,613	849	210,156
Vlera e mbetur neto				
Gjendja me 31.12.2018	-	-	-	-
Gjendja me 31.12.2019	-	-	-	-
Gjendja me 31.12.2019	1,549,826	23,064	4,976	1,577,865

10 LLOGARI TE PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme paraqiten si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Furnitorë	16,915,644	7,716,348
Nenkontratore per sherbimet e punimeve	62,669,068	24,682,517

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

Totali	<u>79,584,712</u>	<u>32,398,865</u>
---------------	-------------------	-------------------

11 DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore në datën e raportimit përbëhen nga:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Tatimi mbi fitimin	-	689,300
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	14,508	9,566
Tatimi në burim	8,805	-
Totali	<u>23,313</u>	<u>698,866</u>

12 DETYRIME TE TJERA AFATSHKURTRA

Detyrimet e tjera afatshkurtra përbehen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Parapagime të marra në Euro	116,717,449	151,763,535
Detyrime ndaj kompanise meme	615,900	-
Shpenzime të llogaritura	2,848	6,010,973
Totali	<u>117,336,196</u>	<u>157,774,508</u>

13 SHITJET NETO

Shitjet neto paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura nga sherbimi	279,107,021	49,899,592
Totali	<u>279,107,021</u>	<u>49,899,592</u>

14 PUNIME NGA NENKONTRAKTORE

Punimet nga nenkontraktoret paraqiten në tabelën e mëposhtme:

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Nentrajtime ne ndertim	(189,340,626)	(37,610,094)
Nentrajtime per punimet elektrike dhe mekanike	(27,690,829)	-
Lëndë të para dhe materiale të tjera	(8,750,070)	-
Totali	<u>(225,781,525)</u>	<u>(37,610,094)</u>

15 KOSTO E PUNES

Kosto e punës përbëhet nga pagat bruto të punonjësve dhe kostot e sigurimeve shoqërore që paguan shoqëria si më poshtë. Numri mesatar i punonjesve per 2019 eshte 2 (2018: 2).

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Kontributet e sigurimeve	(174,096)	(66,482)
Totali	<u>(174,096)</u>	<u>(66,482)</u>

16 SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera përbëhen si mëposhtë:

	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Viti i mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime per sigurime	(14,038,049)	
Shpenzime konsulence teknike dhe profesionale	(12,557,719)	(6,014,103)
Shpenzime per personal jashte njesise	(9,865,174)	
Shpenzime per transferime, udhetime, dieta	(3,076,446)	
Shpenzime të tjera te ndryshme	(1,206,539)	(1,802,450)
Shpenzime per materiale te pastokueshme	(888,477)	
Shpenzime per pritje e perfaqesime	(734,323)	
Shpenzime Qiraje	(534,218)	(30,131)
Shpenzime transporti	(450,630)	
Taksa dhe tarifa vendore	(433,375)	(23,125)
Shpenzime per sherbime fiskale dhe kontabel	(430,770)	
Shpenzime për shërbimet bankare	(133,566)	(49,160)
Shpenzime telekomunikacioni	(99,619)	(611)
Penalitetet, gjoba e dëmshperblime	(34,578)	(856)
Totali	<u>(44,483,483)</u>	<u>(7,920,436)</u>

17 SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2019.

IMPRESA DI COSTRUZIONI ALBINI E CASTELLI S.R.L. - Dege e shoqërisë së huaj
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

Deklaratat tatimore të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë regjistrimet dhe deklaratat e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Fitimi (humbja) para tatimit	8,830,997	3,786,307
Shpenzime te panjohura	986,555	79,004
Fitimi i tatueshem neto per vitin	9,817,552	3,865,311
Përqindja e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Tatimi mbi fitimin	1,472,633	734,300
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	7,358,364	3,052,007

18 ANGAZHIME DHE NGJARJE TË KUSHTËZUARA

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështje ligjore të ndërmarrë nga palë të treta kundër saj më 31 dhjetor 2019 që mund të sjellë humbje apo flukse të rëndësishme dalëse në të ardhmen.

19 NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Ngjarje te ndodhura pas datës se bilancit për te cilat bëhen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas date se bilancit për te cilat nuk bëhen rregullime nuk ka.